

AKSESI I AGJENSIVE PUBLIKE DHE PRIVATE NDAJ INFORMACIONIT TE MENAXHUAR NGA SISTEMET E RREGJISTRIMIT TE TOKES

Nga
Romeo Sherko, J. David Stanfield dhe Malcolm D. Childress
Land Tenure Center
Universiteti i Wisconsin - Madison
24 Prill 2000

“ Nje qeveri popullore pa nje informacion popullor, ose pa menytrat e te kerkuarit te saj, nuk eshte vecse nje Prolog i nje Farsi ose i nje Tragjedie; ose ndoshta i te dyjave”. James Madison 1822

PERMBLEDHJE

Ne vendet ne tranzicion te Evropes Lindore dhe Jugore dhe ne Ish Bashkimin Sovjetik, prezantimi i nje ekonomie tregu te orientuar ka qene i shoqeruar nga nje rritje e konsiderueshme e sasise se te dhenave te krijuara. Shqiperia, per shembull, eshte deshmitare e zhvillimit te shpejte te informacioneve te ndryshme rreth tokes qe nga 1991. Megjithate, shume pak vemendje i eshte kushtuar ceshtjeve ekonomike dhe ligjore te shoqeruara me zbatimin dhe mirembajtjen e sistemeve te informacionit te tokes ne periudhen pas 1991. Per me teper, ceshtjet ligjore dhe ekonomike qe lidhen me aksesin dhe shperndarjen ne modelet publike dhe private per perpunimin dhe perhapjen e informacionit te tokes nuk kane qene adresuar ne menyre adekuate. Projektimi i politikave te pershtatshme per garantimin e aksesit te drejte publik ndaj informacionit shteteror dhe per harmonizimin e ceshtjeve ligjore qe lidhen me informacionin e tokes si e drejta e autorit dhe fshehtesia po behet nje ceshtje e rëndësishme per agjensite shtetore Shqiptare. Shtetet e Bashkuara dhe Komuniteti Evropian, megjithese teresisht te ndryshem nga njeri tjetri ne menytrat e tyre, kane evoluar strategji ne lidhje me keto ceshtje. Megjithate ata jane akoma duke hetuar opsionet me te mira per te fituar avantazhe nga perfitimet potenciale dhe per te reduktuar impaktet potenciale negative te perhapjes se lire dhe lehtesisht te informacionit qe lidhet me token dhe per te gjetur balancat e duhura ne krijimin e partneriteteve midis sektoreve publike dhe private. Mjedisi i ndryshem ligjor, ekonomik, politik, historik dhe kulturor i Shqiperise sugjeron qe importimi i paster i strategjive te tilla (duke supozuar se eshte i mundur) mund te mos jete i pershtatshem. Pas paraqitjes se ketyre diferencave, ky referat eksploron opsionet per politikat e informacionit te tokes dhe veprimet ligjore qe mund te perdoreshin ne kontekstin shqiptar. Per me teper, konsiderohet e rëndësishme koha e pershtatshme dhe vazhdimesia e ketyre politikave. Jane paraqitur aresyet per mungesen ekzistuese te bashkeveprimit midis institucioneve publike dhe private dhe jane propozuar menytrat e perfitimit nga nje bashkepunim i tille. Duke qene nje nga diskutimet e para qe adreson aspektet ekonomike dhe ligjore te zhvillimit te informacionit te tokes ne Shqiperi, ky material kerkon aktivite te ndertuara me konsensus, paraqet nje propozim konceptual per cmimin dhe shkembimin e informacionit, dhe sygjeron krijimin e nje “Shoqata Kombetare Gjeomatike” (National Geomatic Association). Materiali gjithashtu raporton mbi rekomandimet e seminarit te sponsorizuar nga Kombet e Bashkuara te mbajtur ne Tirane, Shqiperi ne fillim te 2000 rreth kesaj ceshtje.

1. HYRJJE

Vendet e Evropes Lindore dhe Qendrore dhe Ish Bashkimit Sovjetik ne tranzicionin nga nje ekonomi e centralizuar ne nje ekonomi tregu jane te gjitha te angazhuara ne disa shkalle ne privatizimin e asetëve te shtetit, ne menyre te vecante token (duke perfshire gjithë permiresimet e lidhura me token). Privatizimi i tokes do te thote kalimi i tokes se menaxhuar dhe zoteruar nga shteti ne nje kontroll efektiv, nese s'ka pronesi te shpallur qarte, te individeve private dhe ndermarrjeve ne pronesi private. Ky privatizim i tokes eshte nje nga parakushtet per zhvillimin e nje ekonomie tregu eficente dhe te orientuara. (Banka Boterore, 1996).

Menaxhuesit e burimeve tokesore, si shteterore dhe private, kerkojne informacion rreth tokes qe ato menaxhojne. Kalimin e kontrollit mbi token nga shteti ne individe dhe ndermarrje private e shoqeron kalimi i nevojës per informacion ne lidhje me token nga shteti ne menyre ekskluzive ne nje kombinim te sektorit privat dhe nje kompleti te ristrukturuar te agjensive shteterore me pergjegjesi te te reja duke perfshire sa me poshte:

Informacion i sakte dhe i lexueshem me mundesi aksesit rreth te drejtave te pasurise, ne menyre qe te lehtesohen tregjet dinamike dhe te sigurta te pasurise;

Informacioni rreth efekteve te zhvillimit ekonomik per burimet tokesore dhe ujore, per te zhvilluar programe efektive per mbrojtjen e tokes;

Projektme rreth perdorimeve te ardhshme te tokes, ne menyre te veçante nga investimet e sektorit privat ne zhvillimin urban, per te minimizuar kostot sociale te zhvillimeve te tilla dhe per te rritur te ardhurat;

Duke qene se sistemi ekonomik evolon dhe rritet, investimet ne infrastrukturen fizike (rrugët, rrjeti elektrik dhe telekomunikacioni, sistemet ujore dhe kanalet) duhet te planifikohen dhe zbatohen ne menyre te kujdesshme dhe te shpejte ne nje kontekst te konkurimit te kerkesave publike dhe private mbi token.

Megjithë rritjen e kerkeses per informacion ne lidhje me token, informacioni i disponueshem rreth tokes ose vjen ne forma dhe formate te vjetra nga furnizuesit e meparshem shteterore ose duhet te krijohet per mijera mbajtës te rinj, private te tokes. Sherbimet e regjistrimit te se drejtes se zoterimit jane ne stadet e tyre fillestare te krijimit. Mundesia e perdorimit te tokes per hartzim shpesh eshte e vjeter me dekada dhe keshtu kompletet e te dhenave perdorin kategorite qe nuk i korrespondojne pronesise se re private ose kontrollit mbi token. Zhvillimi i kapaciteteve planifikuese dhe kontrolluese per planifikimin dhe zhvillimin e perdorimit te tokes nuk njih rregullat e ekonomise se tregut bazuar ne interesat private mbi token.

Eshte e qarte qe nevoja te reja per informacionin e tokes jane duke u shfaqur ne menyre te shpejte. Rregullimet e vjetra institucionale per te kenaqur keto nevoja jane te papershtatshme. Ceshtjet e aksesit per cfare vlen informacioni i tokes, per ke dhe me cfare kosto, jane duke u bere me urgjente. Keto ceshje lidhen ngushte me ceshtjet fiskale qe qeverite hasin, konceptimet e rolit te informacionit gjeografik ne zhvillimin ekonomik dhe roli i informacionit gjeografik ne krijimin dhe mbajtjen e institucioneve demokratike.

Ky referat raporton rreth eksperiencave ne trajtimin e sistemeve te reja te informacionit te tokes ne ndjekje te programeve te privatizimit ne Shqiperi, vecanerisht ne kontekstin e ndertimit te nje sistemi te ri per rregjistrimin e tokes. Ne ofrojme propozimet e meposhtme:

1. Per nje tranzicion me te shpejte drejt tregjeve dinamike dhe te funksionueshme te tokes, modelet e reja te zoterimit te tokes krijuar pas privatizimit te tokes duhet te ndiqen nga ndryshime te shpejta ne rolet e organizatave publike tw cilat prodhojne dhe mirembajne informacionin rreth tokes.
2. Nen nje ekonomi tregu te orientuar dhe qeverisje demokratike, me teper mbeshtetje duhet te sigurohet per entet e reja te menaxhimit te informacionit te tokes nese ato shfaqin nje orientim te fuqishem kllentele.
3. Mbrojtja e interesave ekonomike te organizatave te sherbimit publik duhet te shoqerohet me nje analize rrenjesore te nje mjedisi te ri ekonomik ne Shqiperi, ku sektori privat eshte bere nje klient dhe prodhues domethenes i informacionit te tokes. Duke ndeshur kete realitet eshte e veshtire por e nevojshme ne te mire si te institucioneve publike dhe private.
4. Ndarja e informacionit dhe aksesit i hapur rrit eficencen e te dhenave dhe potencialin per mbijetesen e agjensive ne kontekstin e ekonomise se tregut.
5. Ceshtjet ekonomike dhe ligjore te lidhura me informacionin e tokes jane zgjidhur me mire duke perdorur eksperiencat e vendeve te tjera dhe duke provuar zgjidhje te reja ne nje gjetje hap-pas-hapi sesa duke iu pergjigjur problemeve mbi baza te posaçme kur ato shfaqen.
6. Krijimi i nje Shoqate Kombetare Gjeomatike me pjesemarrjen e gjithe aktoreve ne administrimin e informacionit te tokes, duke perfshire si sektoret publik dhe privat, lehteson procesin e hetimit te problemeve qe lidhen me administrimin e tokes dhe gjetjen e zgjidhjeve te pershtatshme.

Megjithese disi tangencialisht me temen tone kryesore, ne e konsiderojme te drejten e autorit dhe fshehtesine si konsideratat esenciale per gjithe ceshtjet e administrimit te tokes qe ne diskutojme ne kete material. Prandaj, ne kemi perfshire si shtojce te ketij materiali nje diskutim te shkurter te ketyre ceshtjeve, duke siguruar informacion rreth zbatimeve ne vende te ndryshme dhe duke propozuar hapat qe duhet te ndiqen nga vendet ne tranzicion.

2. KONSIDERATAT EKONOMIKE TE INFORMACIONIT TE TOKES

Konsideratat ekonomike mund te sigurojne nje baze konceptuale per te udhezuar formulimin e politikave ne lidhje me nje dispozite te re te informacionit te tokes ne Shqiperi. Informacioni i tokes tenton te posedoje nje numer karakteristikash, te cilat e bejne ate nje tip unik te te mirave ekonomike. Kryesorja midis ketyre karakteristikave eshte:

- 1) Informacioni i tokes mund te karakterizohet edhe si nje mall publik dhe si nje mall normal ne varesi te rrethanave te perdorimit te tij. Prandaj, si dispozita publike dhe ajo private e informacionit te tokes kane nje arsytim ekonomik. Vendimet e politikave publike rreth

asaj se cfare informacioni do te sigurohet publikisht dhe cfare do t'i lihet dispozites private mund te kene pasoja domethenese per zhvillimin ekonomik dhe administrimin publik.

- 2) Sistemet e informacionit te tokes shpesh afishojne karakteristikat e nje monopoli natyral, d.m.th. produktet e informacionit te tokes shpesh kane rene ne kostot mesatare pasi masa e kompletit te informacionit rritet (vecanerisht produktet e reja te informacionit te tokes te zhvilluara gjate tranzicionit). Kjo karakteristike mund te lejoje mbajtesit e nje informacioni te caktuar toke qe te sigurojne informacion per perdorimet e deshuruara shoqerore ne mungese te nje politike te informacionit te tokes per interes publik. Kjo gjithashtu do te thote se mund te kete nje tendence per te nen-investuar ne informacionin e tokes per zonat gjeografike te largeta ose kopmlekse, te cilat kane infrastrukture baze te paket per informacionin e tokes, sepse kosto e investimit do te jete relativisht me e larte ne keto zone.
- 3) Informacioni i tokes ka nje kapacitet te larte per te gjeneruar si perfitime dhe jashtesi negative. Keto karakteristika speciale nevojitet te merren parasysh ne projektimin e aksesit te duhur dhe/ose ne politiken e cmimit per informacionin e tokes, vecanerisht per informacionin e tokes te gjeneruar publikisht. Keto jashtesi mund te paraqiten nese informacioni i tokes eshte tregtuar ose paguar nepermjet taksimit dhe ne nje shtrirje te gjere ato jane rezultat i lehtesimit te riprodhimit. Per shembull, imazhi satelitor me rezolucion te larte imarre per studimin e shpyllezim mund te perdoret ne vazhdimesi per permiresimin e kullotave. Te dhenat e rregjistrimit te pasurive rreth vend ndodhjes dhe pronesise se pasurive gjithashtu mund te perdoren per zhvillime te dobishme. Nje jashtesi negative mund te jete kosto sociale e informacionit te tokes qe perdoret nga njerez te paskrupullt per te kercenuar ose rrembyer pronaret e pasurive bazuar ne njohurite e vend ndodhjes dhe vleres se truallit. Nje shembull tjetër i nje jashtesie negative mund te jene pasojat shperndarese te te dhenave te rregjistrimit te pasurise qe perdoren nga nje numer i vogel bleresish per te perqendruar pronesine duke shfrytezuar akseset te ndryshueshme ndaj informacionit rreth disponibilitetit dhe zoterimit te truallit.

Lehtesia e riprodhimit te te dhenave elektronike dhe veshtiresite ne caktimin e cmimeve te “tregut” per informacionin e tokes krijojne kushte ne te cilat keto tipe jashtesish ka mundesi qe te ekzistojne, vecanerisht ne stadet e hershme te dispozites se re te informacionit te tokes. Politikat e ndarjes se te dhenave, vecanerisht midis furnizuesve publike te informacionit te tokes, mund te jene ne gjendje qe te rrisin ne menyre domethenese jashtesite e dobishme te informacionit te tokes, megjithese politikat e ndarjes se informacionit gjithashtu ngrejne problemet e tyre teknike dhe organizative per sa i perket standarteve, formateve dhe nxitesve ne pjesemarrje.

Keto konsiderata ekonomike ne financen e informacionit ekonomik jane vetem nje pjese e nje kompleti ceshtjesh qe nevojitet te merren parasysh ne politikat per dispoziten dhe aksesin e informacionit te tokes ne vendet ne tranzicion. Roli i informacionit te tokes ne ndihmesen per te mbeshtetur institucionet politike demokratike mund te jete shpesh ne konflikt me nevojat per te ardhura te institucionit duke siguruar informacion. Te drejtat e furnizuesve te informacionit te tokes dhe te drejtat e atyre qe i referohet informacioni i tokes jane ceshtje te rendesishme, te cilat nuk jane zgjidhur ne menyre te kenaqshme ne shume ekonomi ne tranzicion, duke perfshire dhe Shqiperine. Seksionet e meposhtme eksplorojne keto ceshtje ne

nje kontekst me te gjere dhe krahasues, i cili trupezon kriteret ligjore, politike, sociale dhe historike.

3. AKSESI I HAPUR KUNDREJT AKSESIT TE KUFIZUAR

Traditat dhe normat ligjore, qe percaktojne rregullat e aksesit ndaj informacionit te tokes, ndryshojne ne ente politike sic ilustruhet nga diferencat midis SHBA me traditen e saj te aksesit relativisht te “hapur” dhe Evropes me tradita aksesit me te “kufizuar”. Edhe kur rregullat e aksesit sigurojne per me shume perdorues qe te kene akses te lehte, ceshtja e tarifave te perdoruesve del gje qe influencon ne ate nese perdoruesit e informacionit te tokes jane inkurajuar apo dekurajuar nga aksesit per shkak te kostos se ketij aksesit.

3.1 Modeli Perendimor

Agjensite shteterore ne menyre tipike mbledhin informacionin e tokes per te kryer mandatet e tyre ne administrimin dhe menaxhimin e tokes. Ne te njejten kohe, publiku i pergjithshem tenton te deshiroje aksesin ndaj te dhenave shteterore, jo vetem si nje menyre per te mbajtur qeverine pergjegjese per veprimet dhe vendimet e saj por dhe per perdorimet private. Duke qene se krijimi dhe mirembajtja e bazave te tilla te te dhenave mund t’i shkaktoje individeve deme potenciale, dhe eshte nje proces i kushtueshem, ceshtja nese qeveria duhet te lejoje aksesin e hapur ligjerisht ndaj te dhenave me kosto te ulet, ose ligjerisht te kufizojte aksesin dhe te aplikojte politika per gjenerimin e te ardhurave qe te mbulojne kostot teresisht, eshte bere nje ceshtje e debatuar gjeresisht, zgjidhja e se ciles ka trupezuar praktika te shumta te ndryshme ne kontekste te ndryshme.

3.2 SHBA

Shume grupe ne Shtetet e Bashkuara ne menyre te sukseshme kane perkrahur aksesin e hapur per te gjeneruar publikisht informacionin e tokes. Aksesit i hapur ndaj regjistrimeve publike eshte i perfshire ne mbrojtjen e fjales se Amendamentit te Pare, lirise se shtypit dhe “te drejtes per t’i bere peticion qeverise per nje sherbim ose ankese” (Matsunaga, 1944). Ne traditen Amerikane qeveria mbahet si pergjegjese jo vetem nga grupet opozitare, shtypi dhe media, por dhe nga qytetaret. Si pasoje, ne SHBA ka evoluar nje tradite per akses relativisht te hapur ndaj informacionit te tokes e ushqyer ne institucione te tilla si regjistrimet vleresuese te takses se pasurise dhe aksesit te hapur per aktet e regjistrimit nga ana e publikut.

Duke vazhduar kete tradite, Akti i 1988 i Lirise se Informacionit i ben regjistrimet federale qeveritare te hapura per publikun. Me perjashtim te informacionit qe lidhet me sigurine kombetare, ceshtjet konfidenciale, raportet bankare dhe disa kategori te tjera, publiku ka te drejte plotesisht per akses ne te dhenat qeveritare. Megjithate, nderkohe qe rregullohet perhapja e politikave ne nivel federal, ky akt nuk siguron udhezues per informacionin shteteror dhe te pushtetit lokal.

Se fundi, nje numer pushtetesh lokale, duke perdorur kete boshllek ne legjislacion, kane konkluduar qe informacioni i mbajtur ne menyre publike nuk duhet te jete i hapur falas dhe ka shkuar ne rritje drejt politikave te perhapjes te orientuara te tregut (Onsrud, 1994b). Per shembull, rezultatet e nje studimi kombetar drejtuar nga Onsrud dhe Lopez tregojne se “mbi

gjysma e agjensive te intervistuar (56%) jane ndare ne nje fare menyre midis ndjekjes se menyres tradicionale te aksesit te hapur kundrejt nje menyre me kufizuese per gjenerimin e te ardhurave shteterore” (Onsrud, 1996).

Duke pare qe pushtetet lokale aktualisht jane duke ndertuar GIS-in e tyre dhe qe shumica e kerkesave per te dhena dhe produkte GIS jane lokale, ekziston nje debat ne vazhdim ne SHBA per te gjetur rrugen e mesme midis aksesit te hapur dhe gjenerimit te te ardhurave. Dallimi qe Onsrud ben midis skedareve te te dhenave dixhitale GIS te grumbulluara per qellime shteterore, produkteve GIS te krijuara nga shteti dhe per shtetin, nga njera ane dhe sherbimeve me vlere te shtuar per nevoja private dhe jo per qellime shteterore nga ana tjetere, sigurojne nje zgjidhje potenciale: duke vene cmim vetem per koston e perhapjes per me pare dhe cdo kurs tregu per me pas (Onsrud, 1996).

Institucionet per regjistrimin e te drejtave per token dhe pasurite e paluajtshme ne SHBA jane ekstremisht te decentralizuara. Nuk ka kadaster kombetare, dhe as Shteti nuk i mban ato. Regjistrat e Akteve te pronesis se jane norma, qe veprojne dhe financohen ne nivel qarku. Mbeshtetja e informacionit te hartes eshte zhvilluar sipas prioriteteve lokale dhe teknikave te percaktuara lokalisht. Informacioni qe permbahet ne Regjistrat e Akteve ne menyre tipike eshte i hapur per t’u pare nga cdo person qe vjen ne Zyren e Qarkut te Regjistrimit te Akteve.

Nuk ka asnje takse ne ngarkim per te kerkuar ne arkivat e akteve dhe dokumenteve te tjera qe i perkasin te drejtave per token dhe pasurite e paluajtshme. Ka taksa te vendosura per vendosjen e informacionit ne arkiva. Taksa e caktuar ne Qarkun Dane, Zyra e Regjistrimit te Akteve, Wisconsin eshte 10\$ per faqen e pare te aktit, plus 2\$ per cdo faqe shtese. Nje akt tipik shitjeje eshte zakonisht nje faqe, ndersa nje hipotekim mund te jete 2-10 faqe. Nje sistem paralel per informacionin e tokes i mbajtur privatisht eshte zhvilluar ne shume juridiksione Amerikane, te quajtura industria e sigurimit te se drejtes. Keto kompani e marrin informacionin e tyre nga regjistrat publike, por e organizojne ate ne menyre tipike duke u bazuar ne parcele, me mire se ne emrin e pronarit si ne regjistrat publike. Ky informacion eshte i mbrojtur ne shkalle te larte dhe aksesit i lejohe vetem kompanive zyrtare mbi bazen e marrjes se aplikimeve per sigurimin e se drejtes se pronareve te interesuar dhe me qellim per pergatitjen e ketyre politikave te sigurimit. Perdoruesit i lejojne keto kompani kur ata blejne ose marrin nje interes ne nje pjese te pasurise se paluajtshme. Ato blejne sigurine qe shitesi i se drejtes eshte pronari ligjor i asaj te drejte dhe se nuk ka kufizime per transakcionet. Kjo kosto mund te ishte analoge me koston e nje kopje te regjistratit ose te librit te tokes ne shumicen e vendeve Evropiane. Kosto e ketyre politikave varion sipas kompanive, por ne menyre tipike varet nga vlere e pasurive. Per shembull, per nje kompani sigurorese te drejte ne Qarkun Dane, Wisconsin, nje politike e drejte kushton \$350 per nje pasuri prej \$100 000. Ka \$1.00 per mije per vleresimin mbi \$100 000 e cila i shtohet tarifes baze prej \$350 dhe \$2.00 per mije qe zbritet nga tarifa baze prej \$350 per vleren e pasurive me pak se \$100 000.

3.3 Traditat Evropiane.

Skenare te ndryshem ekzistojne gjithashtu ne Evrope. Ndersa ka ndryshim midis vendeve te ndryshme Evropiane, qe renditen nga politika relativisht liberale ne Hollande ne politika me te kufizuara te orientuara drejt tregut ne Gjermani dhe Mbreterine Bashkuar, tendenca e pergjithsme ne Evrope eshte qe te lehtesojte disponueshmerine e informacionit publik mbi

token, por me pas te vendose tarifa per publikun per akses ne te dhenat, produktet dhe sherbimet shteterore. Ne mbeshtetje te politikës per mbulimin e kostos per gjenerimin e te ardhurave, Rhind nga Ordinance Survey (OS), Angli, argumenton se venia e cmimeve per te dhenat shteterore eshte nje menyre per te matur “nevojen reale” per informacion, per te reduktuar taksat, per te inkurajuar bizneset private, per te kufizuar pagesen per perdoruesit e te dhenave ne vend te gjithë taksapaguesve dhe per te rritur cilesine e te dhenave. Qeveria aktuale e Mbreterise se Bashkuar nuk ben dallim midis qytetareve, enteve private dhe departamenteve qeveritare; secila hyn ne treg per informacionin e tokes ne menyre konkurrese si nje bleres ose shites. Deshtimi i Sherbimeve Civile per te patur sukses ne nje konkurim te tille ne pergjithesi çon ne ate qe sherbimi te kontraktohet ne sektorin privat (Rhind, 1994).

Duke patur lidhje ne menyre specifike me regjistrat e tokes dhe kadastrat e tokes ne Evrope, ne studim te fundit te 37 shteteve anetare te ECE (duke perfshire Provincat e Kanadase por jo SHBA), 26 shtete lejonin akses te plote per regjistrin e tokes (kartela) ose kadastrin e tokes ne baze te pageses se nje tarife. Ne juridiksione te tjera, aksesit zakonisht lejohej vetem me autorizimin e pronarit te pasurise ose te Regjistruesit. Ka tradita te mire krijuara dhe te ndryshme ne shtete. Keto diferenca jane diskutuar ne nje seminar te fundit, “Seminar mbi Marredheniet Institucione Publike & Sektor Privat ne Krijimin e Sistemeve te Regjistrimit te Tokes”, Komisioni Ekonomik i Kombeve te Bashkuara per Evropën, Komiteti mbi Vendbanimet Njerezore/ Grupi i Punes per Administrimin e Tokes, ne Tirane, Shqiperi, 30 Mars - 1 Prill, 2000.

Rruga e “hapur” konsiston ne ate qe informacioni per token duhet te jete i hapur per te gjithë. Transparenca e tregjeve te tokes eshte me preferueshme me akses te hapur per regjistrimin e tokes dhe informacionin e kadastrës. Te gjithë pjesemarresit, potenciale dhe aktuale, ne transaksionet e tregut te tokes, jane ne gjendje te marrin vendimet e tyre rreth tokes, duke poseduar te gjithë faktet. Kjo pamje e “aksesit te hapur” reflekton gjithashtu principin qe toka ne nje sens ploteson funksionet sociale. Ndersa pronesia private e tokes eshte duke u inkurajuar, eshte komuniteti si nje i tere i cili ne menyre kolektive eshte kujdestari i tokes. Hapja dekurajon mashtrimin, lehteson transaksionet e tregut te tokes dhe siguron qe pergjegjesite sociale te pronareve te ushtrohen sipas pamjes se plote publike.

Menyra e “kufizuar” bazohet ne idene se vetem pronari i tokes dhe personat e autorizuar nga pronari duhet te kene akses ndaj informacionit ne lidhje me pasurine e tij ose te saj te regjistruar. Kjo menyre mbetet ne pikepamjen qe keto jane ceshtje private qe rezultojne nga nje kontrate private dhe nuk duhet te jene pune e askujt tjetër. Shteti duhet te respektojte kete fshehtesi vetem me perjashtime te rralla ligjore, per shembull atehere kur ngrihen ceshtjet e sigurise kombetare ose zbatimit te ligjit.

- Zyra e Regjistrimit te Tokes per Angline dhe Wellsin, per shembull, eshte krijuar ne 1862, por vetem pas 1990 regjistrat e saj u bene teresisht te hapura per inspektimin e publikut. Vetem pas 1 Prill 2000, ka çmim qe paguhet nga bleresi i nje pasurie qe tregohet ne regjistrin e tokes dhe eshte i hapur per shikim nga publiku (tashme nje praktike e perbashket ne shume vende). Nje kopje fizike e nje regjistri ose plani te drejte eshte rreth US\$6.00 ndersa nje kopje dixhitale e nje regjistri eshte vetem US\$3 dhe per nje plan te drejte eshte vetem US\$4.80. Cdonjeri paguan te njejtat tarifa, pa marre parasysh nese ato jane agjensi publike apo kompani private ose individe.

- Ne Moldavi, detajet e transaksioneve te tregut te tokes sigurohen vetem per palet ne transaksion, ose per autoritetet e nje gjykate apo zbatim ligji.
- Ne Letoni, sipas ligjit vetem pronari i nje pasurie te paluajtshme dhe personat qe kane te drejta ne pasuri mund te marrin informacion nga skedaret e pasurive te paluajtshme, regjistrat dhe indeksat personale. Nese persona te tjere deshirojne te marrin informacion, ato duhet te marrin leje nga Shefi i Departamentit te Librit te Tokes. Asnje dokument i skeduar nuk lejohet te dale nga zyra. Megjithate, zyrat publike dhe te bashkise mund te marrin informacion te azhornuar mbi çdo pasuri te paluajtshme ose rreth pasurive te personit ne çdo pjese te vendit. Agjensite huadhenese, agjentet e pasurive te paluajtshme, vleresuesit e pasurive dhe noteret kane marre liçensa per akses relativisht me te lire ne informacionin e librit te tokes. Akoma nuk ekziston nje konsensus i qarte persa i perket çmimit te informacionit te regjistrimit te tokes, megjithese pikepamja dominuese eshte qe tarifat e perdoruesit duhet te paguajne per veprimet dhe zhvillimin e sistemit te informacionit te se drejtes se pronesisë.
- Ne Finlande, cdokush mund te vije ne autoritetet e Kadastres dhe Regjistrat te Tokes dhe te kerkoje te shohe permbajtjen e regjistrave fizike. Hartat kadastrale dhe baza dixhitale e te dhenave nuk permbajne te dhena rreth individeve. Keto te dhena jane te hapura per gjithë llojet e perdorimeve kur paguhet tarifat e perdoruesit. Informacioni i regjistrimit te tokes megjithate eshte me i kufizuar. Kerkohet nje liçense per te patur akses ne kete informacion ne bazen e kompjuterizuar te te dhenave. Kosto e nje informacioni te tille eshte kosto e kopjes se tij, per shumicen e perdoruesve. Megjithate, agjensite qe prodhojne te dhena per administrimin e tokes mund te perdorin falas te dhenat e prodhuara nga agjensi te tjera te administrimit te tokes.
- Ne Norvegji, ne princip ka akses te hapur ndaj informacionit ne regjistrin e tokes. Megjithate, te kerkosh bazen e te dhenave me emer or me numer personal identifikimi eshte e kufizuar me ligj vetem per perdoruesit profesionale per te mbrojtur fshehtesine e pronareve dhe mbajtesve te interesave te tjera mbi token. Nje kompani me pronesi shtetore vepron si me regjistrin e tokes dhe me shitjen e informacionit qe permbahet ne regjister. Cmimi i informacionit varet se sa e larte eshte kerkesa per te, sipas vleresimit te kompanise. Informacioni hipotekor per shembull, eshte shitur me nje çmim me te larte sesa tipet e tjera te informacionit. Bleresit e ketij informacioni e ri-paketojne dhe e rishesin ate, ne menyre tipike tek rreth 20% e ngritjes se çmimit. Te gjithë perdoruesit, publike dhe private, paguajne te njejtat tarifa.
- Ne Spanje, vetem njerezit me nje interes te legjitimuar ne pasuri (normalisht avokatet, noteret dhe agjentet e pasurive) mund te marrin informacion rreth tyre apo te drejtave qe ato mbajne. Ato qe deshirojne informacion duhet te aplikojne per te tek kreu i Regjistratit te Akteve, duke specifikuar qellimin dhe informacionin e kerkuar. Formularet e aplikimit dokumentohen per t'u siguruar qe aplikantet mund te identifikohen ne ndonje dem qe i behet çdokujt nga perdorimi jo i duhur i informacionit te marre nga Regjistri i Akteve. Cmimi i nje pjese te vetme te kerkuar te informacionit eshte rreth US\$2.94, te tille si emri i pronarit te nje pasurie. Informacioni i plote rreth nje pasurie (perskrim i plote, numri i kadastres, gjendaj martesore dhe adresa e pronarit, te gjithë te dhenat rreth kontratave nepermjet te cilave eshte marre pasuria, çmimi dhe menytrat e pageses, etj) kushton US\$23.53.

Ne menyre te qarte, midis ekstremeve te hapjes se plote dhe fshehtesise se plote, ka variante per fshehtesine dhe hapjen. Nje regjister toke mund te jete i hapur vetem per nje grup te specifikuar kerkuesish si zyrtaret publike te autorizuar, noteret, zyrtaret e zbatimit te ligjit ose avokatet. Ne menyre alternative, vetem pjeset e informacionit qe ndodhen ne nje regjister toke mund te hapen per te gjithë. Ne disa juridiksione, çmimi i paguar per nje pasuri mund te shikohet si privat kurse ne te tjere eshte i disponueshem.

Kosto e marrjes se informacionit nga sistemet e informacionit te regjistrimit te tokes varion, me sistemin e sigurimit privat te se drejtes ne SHBA duke u bere shume here me e shtrenjte se sistemet Evropiane. Ne sistemin Amerikan çmimi i aksesit varion sipas vleres se pasurise, me çmime me te larta per pasurite me vlere me te larta, ndersa sistemet Evropiane caktojne nje tarife te prere.

Ne nuk kemi informacion sistematik mbi kostot e marrjes se informacionit per sistemet e regjistrimit te tokes, me perjashtim te rastit Amerikan, ku kosto varte nga kompleksiteti i dokumentave te paraqitur per regjistrim, por zakonisht rreth US\$10-12 per akt. Ne shume vende ne tranzicion, ka nje takse transaksioni te caktuar proporcionale me vleren e pasurise, 2%, per shembull, e cila zevendeson funksionimin e nje takse pasurore dhe qe mund te jete materiale.

Konkluzioni i pergjithshem ne Seminarin e Tiranës ishte qe ne keto vende ku informacioni eshte i disponueshem ne menyre te hapur, i paket nese dalin veshtiresi ose shqetesime si pasoje e hapjes. Informacioni rreth pronesise, te drejtave te tjera te tokes, çmimit dhe vleresimit jane pranuar si informacion komuniteti. Por ne keto vende ku, tradicionalisht, informacioni i tokes nuk ka qene publik, ne menyre te paevitueshme dhe te kuptueshme ekziston nje paralajmerim i vertete rreth ndryshimit te hapjes.

Madje dhe ne juridiksionet me orientim per nje akses me te hapur, aksesit ndaj informacionit te sistemit te regjistrimit te tokes (regjistrat dhe hartave) ishte ne menyre tipike i kufizuar per token dhe pasurine, por çdo kerkese rreth tokes se zoteruar nga nje person i caktuar nuk pranohej si e vlefshme (me perjashtim te Hollandes, ku te gjithë kerkesat e tilla jane te pranueshme). Ne shumicen e juridiksioneve, pikepamja dominuese eshte qe çeshtjet e fshehtesise personale mund te ngrihen nese aksesit per informacion teresisht te hapur rreth qytetareve eshte i lejuar.

Kosto e aksesit te informacionit ne keto sisteme informacioni ehste ne pergjithesi i ulet per perdoruesin tipik, me perjashtim ne SHBA.

4. KONTEKSTI DHE EKSPERIENCA E VENDIT NE TRANZICION: RASTI SHQIPTAR

Per te adaptuar keto eksperienca Amerikane dhe Evropiane ne kontekstin e vendeve ne tranzicion, eshte e dobishme te ekzaminohen karakteristikat specifike te rastit Shqiptar qe ne menyre te drejtperdrejte prekin politikat e informacionit te tokes per t'u propozuar. Ne do te flasim kryesisht rreth informacionit “gjeografik” (hartave) dhe jo rreth informacionit qe ka te beje me te drejtat per token.

Ka patur mungese te legjislacionit ne Shqiperi per te rregulluar politikat e agjensive shteterore bashkekohore, te lidhura me krijimin dhe shperndarjen e informacionit, si lloje te tjera informacioni, megjithese disa ligje te vjetra dhe vendime qeverie jane akoma ne fuqi. Per shembull Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr.110, i dates 17 Maj 1984, thekson se cdo lloj pune topogjeodezike e drejtuar ne Shqiperi, duhet te ndjehet rregullat e caktuara nga Instituti Topografik Ushtarak, dhe agjensite duhet t'u dergojne ketij instituti nje kopje te planit te pergjithshem te shperndarjes se vendeve industriale, koordinatat dhe lartesine e te gjitha objekteve ndertimore, katalogeve me koordinatat e pikave te densitetit dhe shume te dhena te tjera qe jane te lidhura me punen e kryer. Ne qofte se nje vendim i tille kishte "kuptim" per kohen kur ai u draftua, sot ne ekonomine e tregut, ai eshte vjeteruar, por nga ana teknike eshte akoma ne fuqi. Nderkohe nevojat e situatave te reja, si politika e aksesit per te dhena te paperpunuara, hartat treguese te regjistrimit dhe kopje elektronike te kartelave (dmth dokumentat e pronesise) nuk jane adresuar. Bashkepunimi i institucioneve shteterore me njera-tjetren dhe me sektorin privat, per te draftuar legjislacionin e duhur per informacionin e tokes, eshte kyçi i arritjeve te nje baze ligjore solide, per te ardhmen e administrimit te informacionit te tokes. Persa i perket synimeve per te draftuar akte ligjore qe do t'i sherbejne ne menyre ekskluzive vetem interesave te institucioneve publike dhe do te kufizojne aksesin e agjensive private per informacionin, mund te funksionojne ne nje periudhe kohe, por nje legjislacion i tille nuk do t'i mbijetoje "lojes se re" te ekonomise se tregut ne teresi.

Ne menyre tradicionale, shteti ka qene i vetmi grumbullues i te dhenave hapesine ne Shqiperi. Ne kushtet e nje ekonomie te centralizuar dhe shpesh te pakoordinuar, cdo ministri shteterore, me ane te institucioneve te pavarura, krijoi bazen e vet te te dhenave hapesine. Te dhenat e hartave ne shkalle te larte u grumbulluan nga Ministria e Mbrojtjes (shkalla 1:10,000 dhe me te medha) dhe nje fotografim ajror u realizua me pas ne nje zone te Shqiperise dhe me pas cdo vit deri me 1989. Ministria e Bujqesise posedonte te dhena kadastrale per fushat e cdo kooperativave ne te gjitha Shqiperine, dhe ne menyre periodike grumbullonte te dhena mbi produktivitetin e tokes per qellime planifikimi. Harta u prodhuan per tokat pyjore dhe kullotat. Ministria e Ndertimit prodhonte harta urbane te rrugeve, ndertesave dhe karakteristika te tjera topografike te shkalles 1: 500 dhe 1:1000 pothuajse per gjitha qytetet. Te tjeret, si Ministria e Energjitikes dhe Ministria e Transportit, gjeneruan dhe mbajten te dhenat e tyre hapesine. Te dhenat e tyre ekzistuese te gjeneruara gjate regjimit te meparshem jane burimi kryesor i informacionit hapesinor dhe nje pikenisje premtuese per ndertimin e bazave te te dhenave ne te ardhmen.

Kur Shqiperia filloi te levizte drejt nje ekonomie tregu te orientuar, shumica e institucioneve shteterore u bene me te kufizuara ne dhenien e aksesit te te dhenave te tyre, pjeserisht sepse kjo ishte pasuria me vlere qe ata kishin dhe pjeserisht sepse nuk ekzistonin rregulla te krijuara per dhenien e informacionit tek perdoruesit e tjere. Nga qeveria u bene perpjekje per te kufizuar tendencat individualiste te institucioneve per shitjen e informacionit. Per shembull nje Vendim i fundit i Keshillit te Ministrave, No. 505, i dates 26 Tetor 1993, thekson se "te gjitha arkivat topografike te institucioneve qe kane harta, pika gjeodezike dhe te dhena te tjera, te cilat jane prodhuar perpara vitit 1992, dhe te cilat i sherbejne Projektit te Sistemit te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme, duhet te vihen ne dispozicionin e ketij Projekti pa asnje pagese". Ne praktike, megjithate, te tilla perpjekje per te legjislatuar shkembimin e te dhenave kane patur sukses te kufizuar.

Zhvillimet e shpejta te sektorit privat ne Shqiperi kane ndryshuar skenarin ne lidhje me ate se kush po i mbledh te dhenat dhe se kush po e gjeneron informacionin. Sot, sektori privat funksionon jo vetem per t'i sherbyer nevojave publike mbi procesin e informacionit, por gjithashtu ka filluar te grumbulloje dhe te krijojte bazen e tyre te te dhenave. Ne kete kontekst te ri, bashkepunimi midis sektorit privat dhe publik per te shmangur dyfishimin e perpjekjeve ne grumbullimin dhe perpunimin e informacionit behen edhe me te rendesishme. Krijimi i zyres qendrore te te dhenave per te siguruar te dhena rreth informacionit ekzistues te tokes ne Shqiperi do te jete hapi i pare per rritjen e efciences se ketij bashkepunimi.

Historikisht, qellimi i vetem i grumbullimit te te dhenave ishte qe shteti te kontrolloje dhe te planifikoje me mire ekonomine. Keshtu qe, asnjehere nuk ndodhte qe tek agjensite shteterore publiku te mund te kerkonte per akses ne te dhenat shteterore, sepse nuk kishte asnje nevojte publike per te ne ate kohe. Ndersa planifikimi ishte qellimi kryesor i shtetit ne grumbullimin e te dhenave, perpjekjet nga ministri te ndryshme shpesh nuk kombinoreshin, duke rezultuar ne nje mungese deshire per t'i ndare keto te dhena midis institucioneve. Mentaliteti i vjeter i ngurrimit per mosdhenien e te dhenave publikut dhe mos shkembimit te tyre me institucione te tjera, mungesa e proceduarve te zbatimit te ligjit, ekzistenca e lidhjeve te ndryshme dhe interesave, si dhe tundimi per te mos dhene informacionin per berjen e nje marreveshjeje me nje cmim me shitje te mire per te plotesuar buxhetin e agjensive, nenkupton qe ne lidhje me vendimet, sic eshte Vendimi 505 te vitit 1993 ka qene i dobet.

Nje ndermarrje shteterore, per shembull, ka patur pergjegjesine e prodhimit te hartave topografike te qytetit ne nje shkalle 1: 500 dhe 1:1000. Per shkak te programeve te rikthimit dhe te kompensimit, tregjet dinamike urbane te tokes dhe shume projekteve te huaja ne vazhdim per infrastrukturen e qytetit, keto harta jane me nje kerkese te larte. Politikave vet-financuese, te prezantuara nga shteti si nxitje per institucionet buxhetore-shteterore, kane qene marre, ne nje fare menyre, deri ne ekstrem. Pervec faktit qe rilevimi fushor me i madh u realizua ne fillim te vitit 1992, drejtuesit e ndermarrjes vendosen te ngarkonin me pergjegjesi cdo perdorues potencial te ketyre hartave, duke i konsideruar keto te dhena si te prodhuara per here te pare, dmth kostot e prodhimit te plote per cdo perdorues. Kjo duket me shume si nje ushtrim i fuqise se monopolit dhe do te dukej se sugjeron nje potencial si per rregullore me te forte dhe konkurim me te forte ne dispozitat e hartave te qytetit ne shkalle te madhe.

Mbas privatizimit te tokes, qellimi i grumbullimit te informacionit per token ndryshoi. Se fundi, perdoruesit private te ketij informacioni jane rritur ne numer. Ndersa sektori privat ka realizuar me te shpejte nevojat publike per informacionin dhe eshte drejtuar nga kerkesat e perdoruesve, organizatat shteterore akoma nuk po gjejne mjetet e duhura per te perdorur informacionin qe ata zoterojne per perfitimet e tyre. Nje bashkepunim i ngushte midis sektorit privat dhe publik do te ndihmoje qe t'i kushtohet me shume vemendje nevojave te perdoruesve, dhe te dy sektoret do te perfitojne nga ky bashkepunim.

Programet e fondeve te huaja jane duke gjeneruar informacionin e ri te tokes. Megjithate eshte e kuptueshme qe asistenca e dhene nga ndihma e huaj synon t'i sherbeje intresave te gjera kombetare; duket qarte qe disa institucione jane te prirur drejt mos-bashkepunimit ose deshtimit ne shkembimin e te dhenave. Ne lidhje me aresyet e permendura me lart, mosdeshira e disa furnizuesve te ndihmes se huaj, shpesh te drejtuara nga interesat e tyre te ngushta, ("dmth projekti duhet te vazhdoje") ka kontribuar drejt ketyre tendencave.

Duke percaktuar ne menyre te qarte qellimet kryesore te marrjes se te dhenave, destinacionin dhe mirembajtjen e produkteve finale pas perfundimit te projektit , dhe krijimin e mjeteve per arritjen e ketyre qellimeve duhet te jene problemet primare te ndihmes se huaj, nga fillimi i projektit. Nje institut kerkimor ne Shqiperi, per shembull, mori nje grant te madh per te ndertuar nje njesi moderne te GIS-it. (Arc/Info operojne ne nje RISC-Unix machine) . Njerezit ishin trainuar, brenda dhe jashte Shqiperise, per perdorimin e pajisjeve dhe te programit “Arc/Info”. Ne kete kohe, kjo ndihme u percaktua si e vlefshme per te ardhmen e hartave dhe te GIS-it ne Shqiperi. (dmth do te krijonte ane te jashtme perfituese). Pavaresisht nga keto synime, aksesit per teknologjine e re, akoma nuk eshte lehtesuar. Instituti akoma nuk ka zhvilluar marreveshje bashkepunimi me njesi te tjera publike ose private per hartat dhe rilevimet. Stafi i trainuar per te operuar ne kete sistem e kane lene institutin dhe inxhinjeret e afte kane refuzuar. Te ardhurat jo te mjaftueshme jane gjeneruar per te mbajtur dhe per te permiresuar hardware dhe software.

Megjithese, mund te jete e veshtire nga ana administrative, krijimi i partneritetit midis ndihmes se huaj, institucioneve publike qe marrin ndihme dhe sektorit privat te interesuar ne administrimin e informacionit te tokes, mund te permiresoje te ardhurat e ketyre projekteve dhe do te siguroje vazhdimesine e ketyre inisiativave edhe mbasi ndihma te jete konsumuar. Per shembull, projekti per perdotimin e tokes me nje institut tjeter kerkimor krijoi potencialin per nje njesi eficente GIS-i, por tani ai eshte mbyllur dhe nuk perdoret per arsyen e thjeshte te mungeses se parave nga donatori dhe fondit te pamjaftueshem te buxhetit te shtetit per te mundesuar Institutin qe te zhvilloje metej kapacitetet e veta GIS.

Baza e te dhenave te informacionit te tokes dhe GIS jane te shtrenjta per t’u krijuar dhe per t’u mbajtur. Qeveria shqiptare, duke e marre veten nga kollapsi i nje ekonomie te meparshme te centralizuar dhe duke vuajtur nga renia se fundmi e skemave financiare te te pasuruarit me ritme te shpejta, eshte tani me pak e mundshme per te subvencionuar sistemet e shtrenjta. Ndersa e ardhura e taksas eshte zgjidhja me e zakonshme per te mbuluar investimet fillestare ne informacionin e tokes (argumentimi i mire publik), shqiptaret nuk jane ngarkuar me taksa ne keto vitet e fundit. Pavaresisht nga ligjet e shkruara, shteti nuk ka qene ne gjendje te mbledhe pjeserisht te ardhurat nga tarifa e perdoruesve, taksat e te ardhurave dhe taksat me perfitim nga biznesi privat. Skemat e taksave shpesh shoqerohen nga mashtrimi dhe nga korrupsioni. Nuk ka patur ndonje mekanizem te gjere te suksesshem per mbledhjen e taksave nga te ardhurat personale te qytetareve, pervec atyre te punonjesve publike. Ligji 7805, mbi “Taksat e Pasurive” u kalua ne Mars te 1994, por nje vendim i qeverise caktoi qe ligji nuk duhet te hyje ne fuqi perpara vitit 1996. Me vone, nje vendim tjeter e spostoi hyrjen ne fuqi te tij deri me 1998. Pamundesia aktuale e qeverise per te mbledhur ne menyre te plote taksat, e con politiken e perhapjes se informacionit ne menyre rritese ne drejtim te gjenerimit te ardhurave.

Nje menyre per te pakesuar kerkesen e institucioneve shteterore per burimet financiare nga Shteti do te jete bashkepunimi me sektorin privat per krijimin dhe mirembajtjen e informacionit te tokes ne menyre qe te ndahen kostot. Rregullat e perpiluara per te rregulluar kete bashkepunim jane te nevojshme per te gjeneruar perfitimet e pritshme nga te dyja palet. Ndersa sektori privat merr pjese per te mbuluar nje pjese te shpenzimeve te sistemeve te bazes se te dhenave qe mund te krijohen, ajo duhet te kompensohet nga organizmat shteterore per lehtesimin e aksesit te informacionit, teknologjise dhe asistences teknike.

Shume agjensi shtetore ne Shqiperi nuk i kane perballuar ndryshimet e shpejta nga nje sistem i centralizuar tek nje ekonomi tregu e orientuar, e drejtuar ne menyre administrative ose financiare. Buxheti i ulet i ketyre agjensive, dmth pagat e ulta te punonjesve, nuk jane ne gjendje te terheqin dhe te mbajne profesioniste dhe eksperte te afte. Ne vend te saj, shume nga ata kane zgjedhur krijimin e biznesit privat ose jane larguar jashte shteti per mundesi me te mira. Informacioni rreth tokes, qe karakterizohet nga nje perfshirje ne nje shkalle me te madhe te teknologjise moderne, kekron angazhim profesional nga fusha e rlevimit, hartave dhe shkences se kompjuterit. Ne mungese te saj, te dhenat shume shpejt vjeterohen dhe vlefshmeria e tyre nuk pranohen. Nje menyre per te shmangur demtimin eshte qe institucionet e sektorit publik te bashkepunojne me biznesin komercial.

Tani ekziston nje numer i konsiderueshem i kompanive private ne rlevimin, hartimin dhe GIS-in ne Shqiperi. Ka disa kompani te cilet kane grumbulluar nje numer profesionistesh nga akademia dhe inxhinieret nga kjo fushe, dhe kane prodhuar nje numer modelesh te GIS-it per projekte te ndryshme ne Shqiperi. Me shume kompani private me prespektive po afirmohen cdo dite. Duhet te shpresohet qe sektoret private do te vazhdojne te forcojne rolin e tyre ne GIS dhe sektoret e informacionit te tokes. Ky zhvillim duhet t'i nenshtrohet ne menyre te pashmangshme agjensive shtetore me tendenca monopolesh ne nje fare menyre per konkurimin.

Duke perballuar realitetin e sherbimit te nje klientele te re dhe sigurimi i nje qendrushmerie financiare eshte nje nga pergjegjesite me te veshtira per ato vende qe ne menyre te shpejte ndryshojne nga nje sistem i vjeter tek nje sistem i ri. Deshira e institucioneve shtetore per te mbajtur te njejtin kontroll mbi te dhenat si ne te kaluaren eshte teper e veshtire dhe e kushtueshme ne kushtet e ekonomise se tregut. Ne te njejten menyre, perpjekjet nga sektori privat per te perfituar nga veshimet e informacionit nga institucionet shtetore nuk do te zgjasin pafundesisht. Ne keto kushte, menyra me e mire per te dy palet eshte qe te gjejne menyrat e bashkepunimit me njeri-tjetrin per te parashtruar ate c'ka eshte me e mira. Konkurimi ne mes te sektorit privat dhe publik nuk ka rezultuar te gjeneroje rezultate te mira, vecanerisht ne kushtet e nje vendi demokratik sic eshte Shqiperia, i cili ka mungese te nje baze ligjore te sakte per informacion ne pergjithesi, dhe informacion te tokes ne vecanti. Duke ndertuar baza ligjore dhe administrative per bashkepunim potencial ne mes te sektoreve private dhe publik mund te permiresohen rezultatet e ndonje iniciative. Megjithate asnje pohim nuk mund te behet ku te thuhet se ky proces eshte i lehte.

Shteti mund te ndihmoje, ose te kufizoj, rolin e sektorit privat nepermjet dhenies, ose kufizimit, te aksesit te hapur per te dhenat. Ne teresi, bashkepunimi publik-privat duket sikur e shton ndihmen sociale, ne qofte se ai ndalon kontrollin mbi monopolin, ul kostot dhe permireson cilesine dhe perdorimin e te dhenave. Ne qofte se konkurimi mbetet i ngushte ose ne qofte se bashkepunimi publik-privat krijon monopole te reja, ndihma sociale eshte veshtire te shtohet. Inkurajimi i konkurimit dhe bashkepunimit publik-privat fiton mbeshtetje nga karakteristikat ekonomike te ofruara ne Seksionin 2. Ne qofte se te dhenat e paperpunuara konsiderohen si te mira publike, shkembihen brenda shtetit dhe behen te aksesueshme per cmime te aresyeshme, konkurimi ne produktet e te dhenave te perpunuara, eshte inkurajuar, dhe ane te jashtme perfituese jane me shume te ngjashme.

Tradicionalisht, shteti shqiptar ka patur nje monopol mbi cdo te dhene te gjeneruar ne kete vend. Eshte e drejte te thuhet qe nje qendrim i kontrollit te nje monopoli te tille ka gene i

ngulitur ne mendjen e shume administratoreve te agjensive shteterore. Si rezultat, eshte e rralle te gjesh administratore te cilet rekomandojne “aksesin e hapur” te te dhenave. Nga ana tjetër, pasojat e renda mund te rrjedhin nga tendenca e agjensive shteterore per te kontraktuar me kompanite e preferuara private dhe, keshtu te transferoje kontrollin mbi te dhenat ne nje numer te kufizuar te kompanive private me tendenca te njejta monopoli. Sigurimi i informacionit i barabarte per te gjitha entet duhet te jete primar per agjensite e shtetit shqiptar, krijuesit e politikës dhe zbatuesit e saj.

Fuqia blerese e popullsisë shqiptare eshte shume e ulet. Pavaresisht nga synimi i qeverise per te kryer politikën e gjenerimit te te ardhurave, duke e ngarkuar publikun me cmime shume te larta per te dhena shteterore, duke kufizuar numrin e personave qe mund te paguajne dhe te kene akses per te dhenat. Keshtu, baza e te dhenave shteterore madje edhe me kosto te aresyeshme per aksesin do te jete me pak i perdorshem per shoqerine si nje e tere, ndersa te ardhurat jo te barabarta mund te keqesohen nga vlefshmeria asimetricke e informacionit per palet e fuqishme. Duke e bere informacionin te hapur per te gjithë publikun dhe rritjen e bashkepunimit me sektorin privat do te krijoje potencial per konkurimin e tregut, i cili do t'i detyroje cmimet ne te ardhmen qe te bien.

Nje arsye tjetër per te mbeshtetur aksesin e hapur publik tek informacioni ne kushtet e Shqiperise lidhet me angazhimin serioz te tanishem te shtetit per te luftuar korrupsionin. Ka nje mundesi qe monopolizimi i informacionit dhe kufizimi i aksesit publik ne te do te krijonte mundesi qe persona publike ta konsiderojne kete informacion si te tyre dhe per t'u angazhuar ne veprime jo ligjore. Aksesin e hapur, ne kontrast, i shoqeruar me cmime informacioni te aresyeshme, eshte nje politike afat-gjate qe duhet te rrenjose tek institucionet e shërbimit publik shqiptar per te pakesuar mundesite e korrupsionit.

Duke qene se shteti shqiptar eshte i preokupuar me nje shumëllojshmeri te problemeve te rendesishme, ekziston rreziku qe ceshtjet e politikave te informacionit mund te rishikohen. Pervec faktit qe Shqiperia mbetet pas nga fqinjët ne levizjen drejt nje “shoqerie te informuar” eshte e pashmangshme qe shteti, qytetaret dhe biznesi privat te forcohen per te perballuar ceshtjet ligjore dhe ekonomike te lidhura me informacionin e tokës. Eshte ne interesin me te mire te Shqiperise qe keto ceshtje te mund te adresohen tani, qe baza e informacionit ka filluar te rritet ne menyre te shpejte.

5. DISA PROPOZIME

5.1 Arritja e Konsensusit

Te arrish konsensus mbi rregullat, te cilat drejtojne aksesin e informacionit per token, kerkon nje shkembim idesh dhe problemesh. Arritja e konsensusit kerkon nje angazhim te madh ne keto shkembime te agjensive shteterore, akademike, qytetare, furnizimin e te dhenave, biznesin privat dhe te mesem nga eksperiencia e vendeve te ndryshme. Ne menyre qe te krijojme nje vleresim sa me te sakte te politikave ekzistuese, qendrimeve, polemikat dhe rrymat potenciale, seminarët, qe perfshijne agjensite publike dhe shteterore te cilat perdorin informacione te tokës, duhet te jete mbi ceshtjen e rregullave te aksesit te informacionit. Studimet sistematike te rregullave te shkruara ose te pashkruara te aksesit mbi informacionin e tokës, ne te cilen agjensite prodhuese duhet dhe do te kishin dëshire te kene, do te jene te

dobishme. Te dhenat mbi kostot e prodhimit, riprodhimit dhe te operimit per produktet me kryesore shteterore te informacionit duhet te mblidhen per te sherbyer si baze per cmimet orientuese. Rezultatet e ketyre seminareve dhe studimeve duhet te ndihmojne per te permiresuar projektin e ketyre politikave dhe draftimin e legjislacionit te sakte.

Institucionallisht, do te ishte me vlere te krijonim nje "Shoqate Kombetare Gjeomatike" (SHKGJ) te perbere nga perfaqesues te agjensive publike dhe private, te cilat prodhojne, mbajne ose perdorin informacionin e tokes. Nje "SHKGJ" mund te caktohej me detyren e drejtimit dhe ndihmes se investimeve ne nje infrastrukture informatike gjeografike nderkombetare, dhe gjithashtu te ndihmoje ne draftimin e legjislacionit dhe te rregullave te implementimit per te mbrojtur privatin dhe sigurimin e aksesit te informacionit te tokes.

Duke u bashkuar me iniciativat Europiane per krijimin e Infrastruktures se Informacionit Gjeografik Evropian (EGII, 1996) duhet te jete si nje nga qellimet kryesore te SHKGJ-se, duke perfshire standartizimin e te dhenave kartografike sipas standarteve Europiane.

5.2 Propozimi per Cmimin e Informacionit Gjeografik

Aksesi ne informacionin gjeografik eshte influencuar nga kosto e ketij aksesit. Ka patur dy rruge per nje çmim te tille: 1) rruga e sistemit "te maturuar" dhe 2) rruga e vendeve ne tranzicion.

Bazuar ne eksperiencen e krijuar ne vendet Evropiane per sa i takon çmimit te informacionit te regjistrimit te tokes dhe informacionit kadastral, rekomandimi i pergjithshem eshte qe duhet te fiksohen per gjithë perdoruesit taksat e ngarkuara per informacion, pa marre parasysch fondin e perdorur per krijimin e ketij informacioni:

"Rekomandohet qe duhet te kete nje takse fikse per çdo kerkese te veçante per informacion mbi token duke reflektuar koston aktuale. E njejta takse duhet te aplikohet per gjithë kerkesat pavaresisht nese ato vijne nga qytetaret, biznesi ose organet publike. Taksa te diferencuara mund te aplikohen ne varesi te tipit te kerkeses se informacionit te tokes qe do sigurohet (psh. informacion verbal, inspektim dokumentesh, fotokopje te dokumentave, akses elektronik on-line, etj.). (OKB., 2000, p.7)

Seminari pranoi qe ne vendet ne tranzicion, ku sistemet jane duke u zhvilluar, taksat duhet te mbahen sa me ulet te jete e mundur per te inkurajuar pjesemarrjen ne tregun e tokes.

"Pranohet qe ne vendet ku qeveria aktualisht eshte duke investuar materialisht ne ndertimin e nje sistemi te regjistrimit te tokes dhe kadastral nuk eshte e arsyeshme te kerkohet pagese takse per mbulim shpenzimi. Ne vendet ku jane zhvilluar sistemet e aksesit elektronik, taksat mund te reduktohen si pasoje e kostove te uleta te prodhimit." (OKB., 2000, p.7)

Nje pikepamje pak me e ndryshme eshte qe ne vendet ne tranzicion, ku ka nje financim miks te qeverise dhe granteve te jashtme per krijimin e informacionit te regjistrimit te tokes dhe kadastral, taksat e ngarkuara per akses ne nje informacion te tille duhet te shumefishohen.

Prezantimi grafik i meposhtem integron idete dhe rekomandimet e paraqitura me lart qe kane te bejne me aksesin ndaj informacionit gjeografik duke marre persiper vazhdimesine e informacionit te tokes dhe trajektores se zhvillimit ekonomik te vendeve ne tranzicion (Shih

Figuren 1). Cmimet do te vareshin nga fondet e perdorura per krijimin e informacionit gjeografik dhe nese perdoruesi eshte publik apo privat. Propozohet qe:

a) Te gjitha te *dhenat ekzistuese te hapesires* te krijuara gjate ekonomise se centralizuar per qellime te shtetit duhet t'i jepen pales se interesuar per koston e perhapjes, duke perfshire kostot operuese. (rrjeshti 1-2)


b) Te gjitha te dhenat hapesine qe jane krijuar nga agjensite shteterore, duke perdorur fondet buxhetore shteterore, si permiresime te te *dhenave ekzistuese*, duhet te shperndahen me nje cmim ekuivalent per koston mesatare te shpresuar, per te prodhuar dhe mbajtur te dhenat ne rritje, sipas fakteve qe te dhenat ekzistuese ne shumicen e rasteve jane te vjeteruara; nje pune ekstra nevojitet per t'i dhene publikut te dhenat e kerkuara, dhe se financimi buxhetor shteteror nuk do te jete i disponueshem ne menyre te rregullt per keto qellime. (rrjeshti 3-4)

c) Te dhenat hapesine qe jane krijuar te *reja* nga projekte te financuara nga jashte, mund te shperndahen me nje cmim me te larte se sa kostoja e perhapjes, por e drejtuar nga nje ent supervizioni sic mund te jete SHKGJ; kjo do te siguroje burime financiare te cilat institucionet e reja do t'i perdorin gjate rikonstruksionit. (rrjeshti 5-6)

d) Te dhenat hapesine qe jane krijuar te *reja* nga agjensite shteterore, duke perdorur buxhetin shteteror, duhet te shperndahet tek perdoruesit private per nje cmim me te larte se kostoja e perhapjes, por me i ulet se shkalla e tregut, duke e pranuar ate si te larte. Ky "shkembim te dhenash" do te ndihmoje rikonstruksionin e e institucioneve, duke inkurajuar perdorim te gjere te informacionit te tokes dhe duke stimuluar dispozitat private dhe publik-private te produkteve te informacionit te ri te tokes. (rrjeshti 7-8)

e) Ndonjehere "viti 20xx", kur kushtet ekonomike, mund te shpresohet qe te jene permiresuar, te dhenat e paperpunuara dhe produktet e paperpunuara te krijuara nga agjensite shteterore per qellime shteterore duhet te shperndahen tek publiku per koston e perhapjes. (rrjeshti 9-10) Sherbimet me vlere shtese per nevojat private dhe jo per qellime shteterore duhet te shperndahen sipas kerkeses se personave ne nje shkalle tregu te konkurueshem. (rrjeshti 9-11-12) Ne kete menyre shteti nuk do te monopolizojte te dhenat e paguara nga publiku ose te jape ndihmen e vecante tek ndonje nen-bashkesi e perdoruesve.

Figura 1. Cmimi i Informacionit Gjeografik ne Vendet ne tranzicion ne vitet e ardhshme.



Viti 20xx identifikon kohën kur një vend në tranzicion, për shembull, Shqipëria, do të jetë përmirësuar nga shkaqet ekonomike të së kaluarës, dhe do të hyjë në periudhën e kohës së informacionit me karakteristikat e një vendi përparimor: një shtet demokratik i drejtë dhe shoqëri demokratike; drejtë zhvillimit ekonomik të kënaqshëm; drejtë një sektori të fortë privat; mbledhjen e plotë të taksave nga shteti; rritjen e fuqisë blerëse të publikut; dhe kuadri ligjor i saktë për politikën e informacionit.

5.3 Propozimet për Shkëmbimin e të Dhenave Hapësinore.

Ndërsa shkëmbimi i të dhenave hapësinore konsiderohet si një mjet për të rritur vlefshmerinë e të dhenave të grumbulluara, mentalitetet me një botëkuptim të ngushtë dhe ambicie egoiste të treguara nga institucione të ndryshme publike dhe private, e kanë kufizuar një proces të tillë.

Në paragrafet e mëposhtme, ne do të paraqesim disa argumente për sistemin e regjistrimit të tokës në Shqipëri për të implementuar politikën e shkëmbimit të të dhenave dhe aksesin e hapur të bazës së të dhenave.

a) Përpjekja për të krijuar një Sistem Regjistrimi të Pasurisë së Paluajtshme sa më funksional është një nga projektet me një shkallë të gjërë, me seriozi dhe me një suksesshmëri në Shqipëri. Ky sistem krijon bazat për zhvillimin e një tregu tokës të sigurt dhe ligjor, të dërrshiruar prej kaq kohësh nga shumica e shqiptarëve. Në mënyrë që të plotësojmë këtë qëllim, rritja e numrit të njerezve që duhet dhe mund ta përdorin këtë sistem, bëhet prioritar. E vetmja mënyrë për të arritur këtë qëllim është të përcaktojmë politikën e duhur për shkëmbimin e të dhenave dhe aksesin publik të hapur të informacionit të SRPP-së. Kjo politika krijon premisa për të drejtat e barabarta të individëve për të dhëna publike, një kusht me shumë për lëvizjen drejt një shoqërie demokratike.

b) Që nga fillimi i projektit, SRPP-ja u vendos që të ishte e pavarur nga politika. Mbatja e sistemit të regjistrimit të tokës larg nga politika është kusht i rëndësishëm, në mënyrë që sistemi të funksionojë sa më saktë në teresi. Përveç masave të tjera, një mënyrë për të pakesuar ndikimin e ndryshimeve politike në Shqipëri, është që sistemi i regjistrimit të jetë i hapur me publikun. Përndryshe do të bëhet burim për veprime jo të sakta nga forcat politike.

c) Një nga shkaqet jo të favorshme të trashëguara nga sistemi i vjetër, është mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit në mes të institucioneve të ndryshme në Shqipëri. Një bashkëpunim i tillë është i vështirë për t'u arritur edhe në një shoqëri demokratike. Megjithatë, mëqenëse të dhënat e SRPP-së mund dhe do t'i shërbejnë interesave të shumë ministrive dhe institucioneve publike dhe private në Shqipëri politikën për shkëmbimin e të dhenave duhet të draftohen sa më shpejt të jetë e mundur. Shkëmbimi i të dhenave nuk duhet të konsiderohet si një proces "i shpërndarjes së të dhenave". Por, SRPP-ja duhet të përdorë këtë shkëmbim të të dhenave edhe për të përfutur institucione të tjera. Për shembull, Ministria e Financës është e interesuar në të dhënat e pronësive, si një mjet për të lehtësuar procesin e mbledhjes së taksave. Një mënyrë që SRPP-ja të përfutojë nga ndarja e të dhenave

me kete Ministri, do te jete organizimi i nje marreveshje qe Ministria e Finances te raportoje te gjitha mosperputhjet ne pronesi ose identifikim te zbuluar ose te raportuar nga paguesit e taksave. Kjo do t'i sherbeje SRPP-se per te korrigjuar te dhenat e tyre me nje kosto minimale.

d) Permiresimi i vazhdueshem i saktetise se regjistrimit sherben si premise qe SRPP-ja te filloje te mendoje per krijimin e produkteve informative te vleres se shtuar, te cilat mund t'i shiten bleresve shtetere dhe privat, dhe keshtu te mund te gjenerohen te ardhurat per institucionin. Per shembull, kompanite e konstruksionit te rruges kane nevojte per informacion mbi pronesine e tokes pergjate autostrades. SRPP-ja mund t'i prodhoje keto te dhena (me vleres shtese) dhe eventualisht t'ia shese ato paleve private te interesuar me nje cmim tregu.

e) Duke qene se SRPP-ja eshte nje nga institucionet e para qe prodhon te dhena masive per ate kategori perdoruesish qe jane te interesuar, politikat per implementimin e nje aksesit te hapur dhe te lire duhet te jene fleksibel ne menyre qe t'i pergjigjen ndryshimeve te tregut qe mund te ndodhin ne te ardhmen.

f) Duke aplikuar politikat e shkembimit te te dhenave dhe aksesin e hapur te informacionit, numri i perdoruesve te ketij informacioni do te rritet. Duke patur me shume pjesemarres ne iniciativat e shkembimit te te dhenave do te ndihmoje per te krijuar ide me te mira per krijimin e standarteve te te dhenave te hapura dhe te GIS-it, dhe do te marre ne konsiderate mendimet e nje grupi me te madh perdoruesish dhe furnizuesish te te dhenave.

g) Ne procesin e shkembimit te te dhenave me agjensi te tjera, SRPP-ja do t'e pasuroje bazen e te dhenave, e cila perben bazat e krijimit te mbulimeve te ndryshme te GIS-it. Krijimi i lidhjeve te ndryshme me agjensi te tjera do te krijonte potencialin ne bashkepunimin e krijimit te nje "Shoqeri Kombetare Gjeomatike" ne Shqiperi.

h) Vetem ne qofte se drejtohet nga nje politike e shkembimit te te dhenave dhe nje akses i hapur per informacionin, do te ishte mire te kryej nje investigim me i mire i aspekteve ligjore dhe ekonomike te informacionit te tokes, sic eshte per shembull e drejta e autoresise, privati ose pergjegjesia, duhet te kryhen. Rezultatet e nje analize te tille mund te perdoret per implementimin e legjislacionit te duhur qe lidhen me ceshtjen e informacionit te tokes. Rendesia e shkembimit te informacionit, si dhe nevojta e menjanimi te publikimit te mbajtjes se regjistrimit eshte njohur gjithashtu ne Seminarin e WPLA te OKB, i cili ofroi rekomandimet e meposhtme:

"Rekomandohet qe organizatat qe mbajne regjistrimet e tokes duhet te ekzaminojne mundesite per te permiresuar veprimet e tyre duke ndare informacionin dhe duke koordinuar sherbimet e informacionit te tokes qe ato i sigurojne perdoruesve. Objektivi duhet te jete qe te reduktoje koston dhe te permiresoje sherbimet ndaj publikut. Qellimi duhet te jete qe te mundesoje perdoruesit per te patur akses ndaj gjithe informacionit te tokes qe eshte i disponueshem ne menyre publike nga nje vend i vetem i kerkeses."

"Per te arritur keto synime dhe objektiva rekomandohet qe vendet duhet te krijojne nje bord kombetar koordinimi me perfaqesues nga gjithe organizatat qe mbajne informacionin publik te tokes." (OKB, 2000, p.8).

5.4 Aksesit Publik Per te Dhenat e Regjistrimit te Tokes

Seksioni 30 i Ligjit No. 7483, 13.07.1994, "Mbi Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme", thekson se "Cdo person mund te ekzaminoje dhe konsultojte cdo regjister dhe mund te kerkoje nje kopje te verifikuar te saj, nje pjese te Hartes Treguese te Regjistrimit, ndonje instument i failuar ose plan i rilevimit i depozituar ne Regjister, duke prezantuar nje kerkese ne forme te shkruar dhe duke paguar taksat e duhura". Kjo do te bente qe Zyrat e Regjistrimit neper Rrethe te krijonin lehtesira, ne menyre kompjuterike ose manuale, ne menyre qe te lejoje publikun te komunikojte ne zyre dhe te kerkojne informacionin qe u duhet. Nje opsion eshte qe te skanohen te gjitha dokumentat qe hyjne ne Zyrat e Regjistrimit dhe te vendosen dokumentat e tille ne nje lehtesi e cila eshte lehtesisht e aksesueshme per publikun. Nje lehtesi e tille mund te menaxhohej nga nje kompani ne bashkeveprim me SRPP.

Nje lehtesi tjetere do te ishte per hapje ne menyre te thjeshte te Zyrate te Regjistrimit per kerkime pas oreve te sherbimit publik, jo vetem qe do te gjenerojte te ardhurat per zyrat e regjistrimit (taksat per kerkime te tilla duhet te percaktohen), por gjithashtu do te lehtesojte procesin e regjistrimit per perdoruesit, te cilet mund te kene nevojte te regjistrojne nje transakcion. Ne te njejten kohe, nje nepunes i Zyres se Regjistrimit, i cili do te ndihmoje te interesuarin ne kerkimin e tij/ose te saj, mund te keshilloje gjithashtu mbi llojet e dokumentave qe ai/ajo do te kete nevojte per te kryer nje transakcion ne te ardhmen. Kjo ndihme qe do t'u jepet njerezve, do te pakesoje ngarkesen e punes ne Zyren e Regjistrimit gjate oreve te sherbimit te popullit.

6. KONKLuzionET

Aksesi ndaj informacionit ne vendet ne tranzicion, ne kete rast ne Shqiperi, eshte nje teme qe i eshte kushtuar pak vemendje. Ndersa periudha e privatizimit te pasurive po ecen ne rrugen e saj drejt perfundimit dhe konsolidimit, jane duke u shfaqur nevoja te reja per informacionin e tokes ne nje kontekst te ekonomise se tregut, si nga palet private dhe nga perdoruesit qeveritare me mandate te ndryshueshem. Ne fazen e ketyre zhvillimeve, ceshtjet e aksesit ndaj cfare lloji informacioni, per ke dhe me cfare kosto, jane bere me urgjente. Keto ceshtje jane te lidhura ngushte me ceshtjet fiskale, konceptimet e rolit te informacionit gjeografik ne zhvillimin ekonomik dhe roli i informacionit gjeografik ne krijimin dhe mbajtjen e institucioneve demokratike.

Diskutimi prezanton shembuj te propozimeve qe ne orfruam ne fillim, qe karakterizojne institucionet e informacionit te tokes in ekonomite ne tranzicion duke qene se jane bere te kufizueshme ne perballimin e kerkesave te reja qe shfaqen, ndersa ne te njejten kohe perballojne sfidat e veshtiresive financiare.

Per te shmangur kostot e medha sociale dhe ekonomike ne menyre potenciale qe ne i shohim si pasoja te institucionalizimit te metejshem te marreveshjeve aktuale te prodhimit te informacionit te tokes, ne se pari paraqesim nje argument ekonomik per politiken e cmimit te informacionit e cila ve theksin ne rregulloren e cmimit nepermjet monopoleve qeveritare te informacionit te tokes dhe inkurajimin e konkurimit per prodhimet jo thelbesore te informacionit te tokes midis enteve publike, publike-private dhe private. Duke permbledhur edhe nje here diferencat midis aksesit te hapur te SHBA dhe traditave te aksesit te kufizuar Evropian, ne argumentojme ne favor te nje varianti te politikës se aksesit te hapur i cili balancohet nga nevoja per te mbajtur institucionet te qendrueshme nga ana financiare

nepermjet nje niveli minimal te gjenerimit te te ardhurave. Financimi publik i mbledhjes se te dhenave, i çiftezuat me ndarjen nderqeveritare te te dhenave dhe inkurajimin e nje tregu te ndershem per prodhime dytesore te dhenash duket se eshte nje drejtim qe mund te ece, por nese merren veprime ne te ardhmen e afert per kete inkurajuar kete shteg zhvillimi. Ceshtjet e se drejtes se autorit dhe fshehtesise shfaqen ne rritje pasi me shume produkte informative origjinale jane krijuar dhe me shume te dhena personale jane mbledhur, ndersa riprodhimi dhe aksesit eshte bere me i lehte nepermjet mjeteve elektronike. Ne rekomandojme qe principet baze per ruajtjen e fshehtesise duhet te trupezohen ne politiken e informacionit gjeografik qe ne jemi duke perkrahur. Ky argument eshte i lidhur ne praktike me propozimin per te kryer aktivitetet per krijimin e konsensusit rreth aksesit te informacionit te tokes, per te kryer kerkim te metejshem rreth nevojave te te dhenave dhe kostove reale te ketyre te dhenave dhe per te krijuar nje Shoqate Kombetare Gjeomatike si nje organ koordinues per punen rreth legjislacionit, standarteve, formateve dhe rregulloreve te çmimit per informacionin gjeografik.

SHTOJCA A

MENYRA E KONTRATES PER TE DREJTEN E AUTORIT.

E drejta e autorit eshte forma e njohur nderkombetare e te drejtave pasurore intelektuale “te disponueshme per pronaret e bazes se te dhenave dhe krijimet” (Lopez, 1993). Nje e drejte autori ka dy qellime kryesore: (1) per t’i dhene autoreve nje shkalle monopoli mbi punen e mbrojtur, pra duke inkurajuar orvatjet e dobishme njerezore dhe investimin ne punen prodhuese; (2) me te pakapshem, tashme njelloj te barabarte; per te inkurajuar publikimin dhe shperndarjen e informacionit” (Hollande, 1994).

Ne Evrope mbrojtja e se drejtes se autorit per bazen e te dhenave GIS eshte “pergjithesisht e ruajtur per furnizuesin origjinal ose rregulluesin e te dhenave dixhitale te paperpunuara.” (Lopez, 1993). Sistemet e se drejtes se autorit neper Evrope ne pergjithesi bien ne tre kategori:

- sistemi droit d’auteur - Evropa Kontinentale;
- sistemi i ligjit te perbashket - Mbreteria e Bashkuar, SHBA dhe vendet me ligj te perbashket dhe
- sistemi socialist - Ish Bashkimi Sovietik dhe me shtrirje te gjere, Evropa Lindore.

Agjensite qeveritare Evropiane ne pergjithesi shpallin te drejten e autorit rreth pronave te tyre te informacionit publik. Per shembull ne Mbreterine e Bashkuar, hartat e Ordinance Survey (OS) dhe bazes se te dhenave GIS jane te mbrojtura nga Crown Copyright. Perdoruesit e hartave te OS duhet te aplikojne per nje license per te perdorur te dhenat, duke zbatuar rregulloret e Crown Copyright. Taksat e licenses ose çmimet variojne nga nje kosto minimale skajore te nevojshme per te mbuluar kostot e perhapjes se te dhenave, ne çmime substanciale caktuar per te mbuluar kostot totale te zhvillimit te bazes se te dhenave (Lopez, 1993). Ne

shumicen e vendeve te KE, kerkohet “shprehja krijuese” per nje pune per t’u klasifikuar per te drejten e autorit. Megjithate, interpretimi i “shprehjes krijuese” mund te mos jete gjithmone i njejte, veçanerisht ne rastin e hartave dhe GIS ku dallimi midis shprehjes dhe informacionit faktual duket se eshte me i veshitre.

Ne SHBA, Ligji i te Drejtes se Autorit i 1976 siguron kuadrin ligjor per mbrojtjen e bazes se te dhenave. Ka nje diference midis perkufizimit te se drejtes se autorit ne Shtetet e Bashkuara dhe ne Evrope. Ne vend te “shprehjes krijuese” te Ligjit Evropian te se Drejtes se Autorit, nje term tjetër i dykuptimete perdoret ne Ligjin Amerikan: “puna origjinale e autoresise”. Gjithnje e me shume, ndersa mbrojtja e te drejtes se autorit per bazen e te dhenave ne Amerike eshte duke u bere me e kufizuar, “legjislacioni i propozuar brenda Evropes synon ne nje mbrojtje te gjere te se drejtes se autorit” (Lopez, 1993).

Terma si “krijues” dhe “origjinal” lene shteg per keqinterpretime qe shpesh kerkojne nderhyrjen e gjykatave ne zgjidhjen e rasteve te sofistikuara te konflikteve te se drejtes se autorit mbi krijimet fizike. Bile eshte edhe me e veshitre per te percaktuar te drejten e autorit ne rastin e hartave dhe/ose GIS. Per shembull, “origjinaliteti” eshte nje kerkese per te drejten e autorit te hartave, pikerisht si per bazen e te dhenave. Ndersa harta si nje e tere mund te jete origjinale, çdo karakteristike specifike mbi nje harte nuk mundet. Nen nje interpretim te tille, e drejta e autorit te hartes mund te shtrihet per hartat si nje e tere, por jo per karakteristika specifike si rruget, tubacionet e ujit dhe vegjetalet. Johnson veren se hartat dixhitale mund te manipulohen lehtesisht, ne menyre te ngjashme me bazen e te dhenave, per te prodhuar harta te reja dhe me mundesi te drejte kopjuese” (Johnson, 1995).

Ne Shqiperi idea e se drejtes se autorit eshte e re. Ne te kaluaren, gjithe punet e publikuara jane prodhuar nga qeveria, e cial kishte kontroll te plote mbi gjithe prodhimet, pa marre parasysh nivelin e “krijimtarise” ose “origjinalitetit”, disa here bile duke konfiskuar çmimet ne te holla dhene figurave Shqiptare gjate konkurimeve nderkombetare. Ne Maj 1992, Parlamenti aprovoi Ligjin 7564 per “Te drejtat e Autorit”, i cili bazohej ne nje model Evropian. Ky ligj percakton te drejtat morale dhe financiare dhe kohezgjatjen e e te drejtes se autorit. Megjithate, asnje seksion i ketij ligji nuk trajton te drejten e autorit te bazes kompjuterike te te dhenave ne pergjithesi dhe te dhenat e rilevimit dhe hartave te kompjuterizuara, ose GIS ne veçanti. Nevojitet legjislacion i veçante i lidhur me bazen kompjuterike te te dhenave. Kerkohet nje projekt i vemendshem i legjislacionit, sepse e drejta teper e gjere e autorit mund t’i beje te dhenat me pak te aksesueshme pasi informacioni behet me teper pronesor. Duke shikuar pertej eksperiencave Amerikane dhe Evropiane te se drejtes se autorit, zyrtaret Shqiptare do te perfitonin nga nje hetim i kujdesshem i ligjeve te se drejtes se autorit, procedurat e zbatimit te ligjit dhe rezultatet pasuese te tyre ne vendet e tjera te Evropes Lindore.

E drejta e autorit me vete nuk mund te jete e mjaftueshme per te shmangur veprimet e paligjshme nga persona te papergjegjshem dhe t’i mbaje ata si te pergjegjshem. Se fundi, jane perdorur kontratat dhe licensat si shtese per dispozitat e se drejtes se autorit:

“Me kontrate, furnizuesi mund te siguroje nje synim me te gjere te mbrojtjes sesa ç’ mund te ofronte e drejta e autorit.... Per me teper, me ane te kontrates, informacioni i siguruar mund te siguroje mbrojtje per materialin qe nuk perfshihen tek e drejta e autorit. Nga pikepamja e furnizuesit, kontrata mund te provoje mjete me terheqese per te patur te njejten mbrojtje ose me te larte se ajo qe eshte e disponueshme nen te drejten e autorit” (Ginsburg, 1994).

Palet ne kontrate mund dhe duhet ne menyre specifike te percaktojne te drejtat e autorit origjinal, te drejtat e bleresit, kufizimet mbi perdorimet dytesore dhe gjobat ne rast gabimi. Megjithate, Johnson ve re qe: “natyra nje aneshe e kontrates (zakonisht e projektuar nga nje agjensi GIS) mund te jete nje pengese per zbatimin e marreveshjes” (Johnson, 1995). Nje çeshtje akoma pa pergjigje eshte sesa fuqishem gjykatat do te zbatojne te drejtat e autorit dhe kontratat persa i takon formave te informacionit te tokes ne Shqiperi.

SHTOJCA B: FSHEHTESIA

Zhvillimi i shpejte i teknologjise, informacionit dhe bazes se gjere te te dhenave ka gjithashtu implikime te rendesishme per fshehtesine e individit. Legjislacioni i lidhur me fshehtesine i shkruar vite me pare shpesh eshte bere i papershtatshem nga zhvillimet e reja teknologjike. Siç veren Onsrud:

“Megjithese kapacitetet kerkimore dhe bazat e te dhenave te siguruara (jane) ekstremisht te vlefshme per bizneset e vogla, ato gjithashtu (jane) te vlefshme per ata qe deshirojne te perfshihen ne vjedhje, mashtrim, ngacmim seksual dhe ne njenumër te madh qellimesh te tjera te ndaluara” (Onsrud, 1994a).

Ne Shtetet e Bashkuara, statuti kryesor federal i fshehtesise eshte Akti i Fshehtesise i 1974. Onsrud pershkruan dispozitat kyçe te ketij akti:

Akti i fshehtesise:(1) u lejon individeve te percaktojne se çfare regjistrimesh qe u perkasin atyre jane mbledhur, mirembajtur ose perdorur nga agjensite federale; (2) u lejon individeve te parandalojne regjistrimet e marra per nje qellim te veçante qe te perdoren ose te behen te disponueshme per qellime te tjera pa pelqimin e tyre; (3) u lejon individeve te kene akses ndaj regjistrimeve te tilla, te bejne kopje te tyre dhe te bejne korrigjime; (4) u kerkon agjensive te sigurojne qe çdo regjistrim qe identifikon individet eshte per nje qellim te nevojshem dhe te ligjshem; (5) u kerkon agjensive te sigurojne mbrojtje te pershtatshme per te parandaluar keqperdorimin e informacionit personal (Onsrud, 1994a).

Megjithate, kritikant argumentojne se dispozitat e aktit jane zbatuar dobet dhe bashkimi me udhezuesit e mbrojtjes se fshehtesise nuk ka qene nje prioritet per agjensite federale (Flaherty,

1989). Ka akte te tjera qe rregullojne çeshtjet e fshehtesise sipas kushteve specifike te tilla si Akti i Mbrojtjes se Fshehtesise dhe Lojes Kompjuterike 1988. Post ve ne kontrast legjislacioni Amerikan me ligjet e ngjashme Evropiane:

“Ne vend te imponimit te kerkeses se pelqimit te individeve per informacionin personal qe mund te mbledhe sektori tregtar, si ne Evropen Perendimore, perpjekjet legjislative ne SHBA synojne te sigurojne saktesine e te dhenave te mbledhura ose te imponoje kushte te tjera qe kane te bejne me perdorimin e informacionit.” (Post 1989).

Komuniteti Evropian aktualisht eshte duke konsideruar rregulla edhe me strikte per mbrojtjen e te dhenave perdonale, megjithese ka ndryshim nga nje vend ne tjetrin. Nje nga shembujt me te dukshem ne te cilin çeshtjet e fshehtesise kane ndryshuar veprimet qeveritare eshte heqja se fundi e regjistrimeve kombetare ne Hollande dhe Gjermanine Perendimore. Per shkak se keto qeveri nuk ishin ne gjendje te rregullonin problemet e qytetareve te tyre mbi fshehtesine dhe keqperdorimin potencial te informacionit personal, rezistenca publike detyroi heqjen e regjistrimeve dhe shume perfitime materiale temarra nga regjistrimi humben (Flaherty, 1989). Raab veren se mbrojtja e çeshtjeve te fshehtesise ka shoqeruar renien e bllokut socialist:

“Midis anetareve te BE, Italia dhe Greqia akoma nuk e kane adaptuar nje ligj kombetar per mbrojtjen e te dhenave dhe deri pak kohe me pare nuk ishte legjislacion Belg te ketij lloji. Eshte interesante, megjithate, qe ndryshimet dramatike qe ndodhen qe nga 1989 ne Evrope, duke perfshire shkrirjen e Ish Bashkimit Sovjetik dhe renien e rregjimeve komuniste ne ish satelitet e saj ne Evropen Lindore, kane qene perpjekje paralele domethenese per legjislacioniin e fshehtesise ne keto vende.... Hungaria, Republika Ceke dhe Sllovaqe, per shembull tashme kane ligje kombetare dhe po merren ne konsiderate edhe ne vende te tjera.” (Raab, 1994).

Ne zonat e mbrojtjes se fshehtesise dhe te dhenave, Shqiperia ka qene prapa vendeve te tjera te Evropes Lindore. Legjislacioni qe ka te beje me fshehtesine dhe lirine personale te informacionit eshte projektuar dhe miratuar (Ligji Nr. 8517, 22 Korrik 1999), por zbatimi ka qene i vonuar. Perderisa nuk eshte krijuar nje baze e madhe te dhenash per individet, mbrojtja e fshehtesise akoma nuk perben nje shqetesim per Shqiptaret. Krijimi i SRPP se shpejti do ta ndryshoje kete situatë. Megjithate, Shqiperia eshte duke perjetuar nje rritje te numrit te kerkimeve, shpesh per te dhena rreth politikaneve.

Komuniteti i informacionit te tokes nuk duhet te prese qe çeshtjet e fshehtesise te arrijne nivele krize perpara se te marret veprimi. Njohurite mbi principet e mbrojtjes se fshehtesise te lidhura me komunitetin e informacionit te tokes (Onsrud, 1994a) do te jene te dobishme jo vetem per legjislacioniin e ardhshem ne vendet ne tranzicion por gjithashtu do te sherbejne si udhezues duke pas parasysh mungesen e ligjit formal. Disa nga keto principe jane:

Principi i Kufizimit te Grumbullimit: Duhet te kete limite ne tipet dhe shtrirjen e informacionit personal te mbledhur, qe permbahet, ose perdoret ne lidhje me sistemet e informacionit gjeografik. Mbledhja duhet te jete e ligjshme, e ndershme dhe me njohurine dhe pelqimin e individit.

Principi i Cilesise se te Dhenave: Te dhenat personale duhet te jene te pershtatshme me qellimet per te cilat do te perdoren.

Principi i specifikimit te qellimit: Duhet te pohohen qellimet per mbledhjen e informacionit personal.

Principi i Kufizimit te Perdorimit: Te dhenat personale nuk duhet te jene te hapura ndaj te tjerëve, te jene te disponueshem per te tjeret, ose te perdoren per qellime te tjera nga ato per te cilat jane mbledhur pa pelqimin e shprehur qarte te subjektit te te dhenave ose nepermjet autorizimit pozitiv te ligjit.

Principi i mbrojtjes se sigurise: Te dhenat personale duhet te mbrohen ne menyre te aresyeshme nga kontrolluesi/administratori i te dhenave.

Principi i hapjes: Zhvillimet, praktikat dhe politikat ne drejtim te te dhenave personale, duhet te ndjekin nje politike te pergjithshme te hapjes.

Principi i Pjesemarrjes se Individit: Subjekti i te dhenave duhet te lejohet per te percaktuar ekzistencen e skedareve te te dhenave rreth vetes dhe per te qene ne gjendje te inspektoje dhe korrigoje te dhenat pa kosto ose me kosto marginale.

Principi i pergjegjshmerise: Kontrolluesit e te dhenave GIS, qofte ne sektor publik ose privat, duhet te mbajne pergjegjesi per zbatimin e ketyre udhezuesve” (Onsrud, 1994a).

REFERENCAT

]Dansby, Bishop H.; Onsrud, Harlan J.; and Milrad, Louis H.; 1992, “GIS Legal Issues”, ACSM Bulletin, Nov/Dec 1992, 140, 40-43.

EGII Policy Document, 1996, GI200: Towards a European Geographic Information Infrastructure.

Epstein, Earl F. and McLaughlin, John D., 1990, “A Discussion on Public Information: Who Owns it? Who uses it? Should we limit accsee?” ACSM Bulletin, October 1990, 128, 33-38

Ginsburg, Jane, 1994, “Surveing the Borders of Copyright”, Journal, Copyright Society of the USA.; 322-334

Flaherty, David H. (1989). “Protecting Privacy in Surveillance Societies”, Chapel Hill and London: The University of North Carolina Press. 467.

Hernon, peter, 1993, “Equity in Public Access to Government Information”, Government Information Quarterly, 10:3, 301-304.

Holland, William Shephard, 1994, "Copyright, Licensing and Cost Recovery for Geographic and Land Information System Data.", Proceedings from the conference on Law, Information Policy and Spatial Databases, October 28-30, 1994, Tempe, AZ: NCGIA: University of Maine, Orono, 152-164.

Johnson, Jeff P. and Onsrud, Harlan J. (1995) "Is Cost Recovery Worthwhile?" Proceedings of the Annual Conference of the URISA. San Antonio, TX: URISA 1:126-136.

Johnson, Jeff P. and Dansby, Bishop H, 1994, "Liability in Private Sector Geographic Information Systems.", Proceedings from the conference on Law, Information Policy and Spatial Databases, October 28-30, 1994, Tempe, AZ: NCGIA: University of Maine, Orono, 285-292.

King, John Leslie. 1995. "Comments on the Economics of Geographic Information and Data Access in the Commonwealth of Massachusetts", in H.J. Onsrud and R. Rushton, eds. Sharing Geographic Information. New Brunswick, New Jersey: Rutgers University Press.

Lopez, Xavier, 1993, "Database Copyright Issues in the European GIS Community.", Government Information Quarterly, 10:3, 305-318.

Madsen, Wayne (1992), "Handbook of Personal Data Protection", New York: Stockton Press.

Matsunaga, Keene and Dangermond, Jack, 1994, "Promoting a Free Access or Minimal Cost of Dissemination Arrangement for Government-Held Geographic Information Systems Data", Proceedings from the conference on Law, Information Policy and Spatial Databases, October 28-30, 1994, Tempe, AZ: NCGIA: University of Maine, Orono, 30-51.

Mulcahy, Karen A. and Clarke, Keith C., 1994, "Government Digital Cartographic Data Policy and Environmental Research Needs", GIS/LIS '94 Central Europe, Budapest, Hungary, June 1994, 47-53.

Onsrud, Harlan J.; Johnson, Jeff P.; and Lopez, Xavier, 1994a, "Protecting Personal Privacy in Using Geographic Information Systems.", Proceedings from the conference on Law, Information Policy and Spatial Databases, October 28-30, 1994, Tempe, AZ: NCGIA: University of Maine, Orono, 239-256.

Onsrud, Harlan J. and Reis, Robert I., 1994b, "Law and Information Policy for Spatial Databases, October 28-30, 1994, Tempe, AZ: NCGIA: University of Maine, Orono, 2-11.

Onsrud, Harlan J., 1990, "Liability Concerns for Surveyors Contributing Data to Public Land Information Systems.", ACSM Bulletin, 125, 20-24.

Post, R.C. (1989), "The Social Foundations of Privacy: Community and Self in the Common Law Tort", California Law Review, 77.5: 957-1010.

Raab, Charles D., 1994, "European Perspectives on Protection of Privacy", Proceedings from the conference on Law, Information Policy and Spatial Databases, October 28-30, 1994, Tempe, AZ: NCGIA: University of Maine, Orono, 257-265.

Rhind, David, 1994, "Spatial Databases and Information Policy: A British Perspective.", Proceedings from the conference on law, Information Policy and Spatial Databases, October 28-30, 1994, Tempe, AZ: NCGIA: University of Maine, Orono, 82-92.

Taupier, Richard P. 1995. "Comments on the Economics of Geographic Information and Data Access in the Commonwealth of Massachusetts", in H.J. Onsrud and R. Rushton, eds. Sharing Geographic Information. New Brunswick, New Jersey: Rutgers University Press.

United Nations, Economic and Social Council, Economic Commission for Europe, Committee on Human Settlements, Working Party on Land Administration, "WORKSHOP ON PUBLIC/PRIVATE SECTOR RELATIONSHIPS IN THE ESTABLISHMENT OF LAND REGISTRATION SYSTEMS", 30 March-1 April 2000, Tirana, Albania, HBP/2000/5, HBP/WP.7/2000/1

World Bank, World Development Report 1996, "From Plan to Market"